


RAPORTI VJETOR 2018





© Julia Lurie
Stable Union 2019

WE ARE THE **NUMBER ONE**
IN AUSTRIA, CENTRAL AND
EASTERN EUROPE.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP
Protecting what matters.

Historia e VIG

Viena Insurance Group është krenare për historinë dhe traditën e saj, gati **190** vjeçare.

1824-1938

1939-1955

1956-1989

1990-2007

2008- Sot

1824-1938

- Rrënjët e grupit të sigurimeve datojnë që nga viti 1824, ku u themelua grupi me i vjetër i sigurimeve, Wiener Stadtische Austria, dhe nga i cili u formua me vonë Vienna Insurance Group.
- Në 1898, lindi paraardhësi i tretë i Vienna Insurance Group.

1939-1955

- Kolapsi i ekonomisë Austriake në fillim të Luftës së II Botërore e la Wiener Stadtische në prag të rënimit.
- Në 1947, kompania ndërroi emrin në “Wiener Stadtische Wechselseitige Versicherungsanstalt”
- Ndertesa e parë e lartë në Austri – RINGTURM

1956-1989

- Në 1958 – vit nga i cili fillojnë statistikat e Shoqatës Austriake të Sigurimit – priset në Austri ishin të barabarta me vlerën ekuivalente të 202 Milion Euro të ditëve të sotme.
- Hapat fillestare drejt zgjerimit – në 1964, Wiener Stadtische firmosën një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë e jetës Jupiter, dhe në 1966 bleu 40% të aksioneve të Österreich Volksfürsorge AG”

1990-2007

- Zgjerimi në Europën Qendrore-Lindore – Wiener Stadtische mori pjesë në themelimin e kompanisë së sigurimit Çekoslovake Kooperativa në Bratislavë, 1 vit pas rënies së Perandorisë së Hekurt
- Prezantimi i grupit si brand “Vienna Insurance Group” u bë në fillim të 2006. Vienna Insurance Group është një familje e madhe, në të cilën çdo kompani e grupit mban emrin e saj si brand dhe gjithashtu VIG si brand të grupit (si emër familje).

2008- Sot

- Bashkëpunimi me Erste Group dhe rritja e biznesit të sigurimeve
- Një rritje e suksesshme kapitali, pavarësisht krizës ekonomike. Krijohet VIG RE
- VIG blen kompani në të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore



Ringturm – Zyrat Qendrore të VIG



Ringturm i veshur me art - 2019

Historia e Intersig VIG

2001

Intersig u themelua ne 2001 nga nje grup aksioneresh vendas te cilet moren licensen per nje kompani Jo-Jete ne Republiken e Shqiperise.

2001-2011

Intersig pati nje rritje te qendrueshme ne market share.

Viena Insurance Group bleu shumicen e aksioneve te Intersig Sh.a, ne baze te nje marreveshje te firmosur ne 24 Gusht 2011 ne Tirane

2011 – Sot

Aktualisht, **VIG** zoteron 90% te aksioneve te **Intersig VIG**. **Intersig** ka nje logo te re dhe fakti qe eshte ne zoterimin e VIG, ka influencuar ne permiresimin e produkteve dhe sherbimeve te ofruara. Intersig VIG ka reformuar shume procese. Intersig ka investuar ne permiresimin e kualitetit te stafit dhe dixhitalizimin e shume proceseve. Produkte te reja si Sigurimi i Shendetit, Easy Casco etj jane bere pjese e portofolit te Intersig VIG.



Intersig VIG - Misioni

- **Vizioni**

Vizioni yne eshte qe te jemi kompania e sigurimit me e besuar dhe e preferuar ne treg

- **Misioni**

Ne jemi te dedikuar per te qene kompania lider ne Shqiperi ne saje te produkteve kompetitive dhe sherbimit me kualitet qe ofrojme. Ne kujdesemi per njerezit ne vecanti. Jemi te dedikuar ndaj te drejtes, bashkepunimit, partenritetit, respektit reciprok, transparences dhe nje marredhenie te qendrueshme.

Kjo eshte ambicia jone per te krijuar nje biznes me atraktiv dhe nje mjedis favorizues per te punuar ne menyre qe te siguroje suksesin.

Ne krijojme vlera solide.

Ne jemi te orientuar drejt nje rritje dhe fitimi te qendrueshem, ku synohet rritja e fuqise tone financiare.

Ne duam te jemi afer klienteve tane bazuar ne praktikat me te mira ne linja te ndryshme biznesi. Keto programe dhe praktika na sigurojne 'customer care' me sherbimin me te mire dhe sherbime inovative me cmime optimale.

Ne jemi te ndergjegjshem per CSR, dhe eshte arsyeja pse ne jemi te angazhuar ne programe sociale dhe projekte dedikuar atyre me mundesi te pakta, dhe femijeve, te cilet do te jene e ardhmja jone.

Premtimi yne: **Make Life Easy!**

Premtimi I VIG: **Protecting What Matters!**



VIG mission statement

OUR MISSION STATEMENT



OUR VISION

We want to be the first choice for our customers. Our stakeholders see us as a stable and reliable partner. This enables us to consolidate our position as the leading insurance group in Austria, Central and Eastern Europe.



OUR MISSION

We stand for stability and competence in the field of risk protection. We use our experience, know-how and diversity to move closer to our customers. We see it as our responsibility to protect the values that matter to our customers.

OUR VALUES

Diversity
Customer proximity
Responsibility

OUR PROMISE

We enable customers to live a safer and better life:
Protecting what matters.



CORPORATE STRATEGY

SUSTAINABILITY STRATEGY

EMPLOYER BRANDING

CORPORATE BEHAVIOUR


Celesi i Suksesit

- Menaxhimi eshte I motivuar dhe ambicioz per zhvillimin e kompanise dhe per te arritur nje market share te rendesishem ne tregun e sigurimeve te shqiperise
- Stafi yne eshte I kualifikuar dhe me eksperiencen e nevojshme per shitjen e te gjitha produkteve te sigurimeve, dhe ato te cilat jane te specifikuara per tregun vendas.
- Nje vemendje e vecante i eshte kushtuar klienteve dhe partnereve tane, bazuar ne Standartet Profesionale te Kompanise.
- Ne mundesojme pagesen e menjehershme te demeve por gjithashtu tregohemi te ftohte ndaj rasteve te mashtrimeve ne sigurim.



Struktura e Aksionereve

■ VIG ■ Z.Gentian Sula



Struktura e Keshillit Mbiqeqyres dhe e Bordit te Drejtoreve


<i>Keshilli Mbiqeqyres</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Bordi Drejtues</i>	<i>Pozicioni</i>
Mr. Peter Hoefinger	Kryetar	Mr. Gentian Sula	Drejtor I Pergjithshem
Mr. Christoph Rath	Zv. Kryetar	Mrs. Fitnete Sulaj	Anetar Bordi
Ms. Michael Hack	Anetar	Mr. Fatmir Berdica	Anetar Bordi

Intersig ne Shqiperi

- Zyrat Qendrore te Intersig VIG jane ne Tirane dhe Intersig VIG eshte I perfaqesuar ne te 13 rajonet e Shqiperise
- Kompania operon ne bazen e nje rrjeti te gjere te degeve, agjencie dhe pikave te shitjes
- Ne fund te 2018, kompania ka punesuar nje numer prej rreth 138 punonjesis




Tregu per Primet e Shkruara Bruto




Intersig ka 11% te tregut per Primet e Shkruara ne vitin 2018 me rreth 13,7 mil euro.

Intersig ka paguar rreth 4.9 Mil Euro Deme gjate vitit 2019. Numri i kerkesave te Demeve te paguara nga Intersig gjate 2018 eshte 9'716 ose 23% e te gjithë kerkesave te tregut.

Demet e paguara ne Vlere



Demet e Paguara ne Numer



INTERSIG VIG – Primet e Shkruara Bruto (EURO)

PRIME TE SHKRUARA FAKTIKE 2013-2018 DHE PLANI 2019-2021



Intersig VIG gjate vitit 2018 ka shkruar rreth 13.75 milion Euro prime. Numri i kontratave te realizuara eshte 130 mije ose 5 % me shume se 2017.


Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Prime Mil Euro	6.28	10.38	12.09	12.32	12.80	13.75

Intersig VIG gjate vitit 2019 ka planifikuar te realizoje 15 milion Euro Prime te shkruara. Plani ne vijim eshte si me poshte:

VITI	2019	2020	2021
PLANI PRIME MIL EURO	15.00	15.76	16.56

Staf I ri

- Kombinimi I stafit te ri ne moshe me menaxhere te cilet kane eksperiencem,
- Fokus ne stafin e ri
- Trajnime te vazhdueshme
- Mundesi te barabarta per karriere
- Motivim I larte



Pergjegjesia sociale

Ne bashkepunim me Bashkine e Tiranës, Intersig VIG ne Dhjetor 2018 shperndau dhurata per femijet me aftesi te kufizuara dhe ata qe vijne nga familje ne nevoje ne Qendren Sociale Multidisiplinare.

Gjithashtu nje sere eventesh kulturore dhe artistike jane mbeshtetur nga Intersig VIG. Gjithashtu si zakonisht eventet nuk kane munguer per ditën e 7-8 Marsit dhe 1 Qershorit;



Edicioni I 9 & 10 I panairit “Work and Study”

Intersig VIG, ne kater vitet e fundit ka marre pjese ne panairin e punes “ Work and Study”. Ky panair shihet si nje mundesi e madhe nga Qeveria Shqiptare per te punesuar profesionistet e duhur.

Organizuar nga: Bashkia Tirane, Ministria e Arsimit dhe Sportit ne bashkepunim te ngushte me Dhomen e Tregtise.

Qellimi I panairit: Organizuar per te sjelle nje epoke te re, me qellimin per te permbushur kerkesat per pune. Eshte pare si e nevojshme nga qeveria keto 10 vitet e fundit per te gjetur personelin e duhur, qe kerkohet nga kompanite.



Trajnime me Deget

Stafi I Zyrave Qendrore te Intersig VIG ka zhvilluar dy takime me Drejtoret e Degeve te kompanise per te diskutuar ne lidhje me problematika te ndryshme dhe per ti dhene zgjidhje.



Raporti i Auditit



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar akcionarëve të Interlig Vienna Insurance Group sh.a

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Interlig Vienna Insurance Group sh.a ("shoqëria") më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parave për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve të parave të përgatitur për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe çështje të tjera.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përfshihen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* në raportin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilitetit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilitetin ("kodi i BSNK"). Ne kemi përmblusur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përbehen nga skedalet suplementare të cilat përfshijnë afësisht paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave tekalike.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk i përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk japim asnjë lloj sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe të konsiderojmë nëse ka ndonjë mospërputhje materiale të këtij informacione me pasqyrat financiare ose informacionin e marrë prej nesh gjatë auditimit. Nëse bazuar në punën e kryer prej nesh në lidhje me informacionet e tjera të marra para datës së këtij raporti, ne arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në këto informacione të tjera, e raportojmë këtë si gjetje. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me këtë çështje.



Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar afërsinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë shoqërinë apo të ndërprisë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç as në sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një prishmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rrezeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësive, për shkak se mashtrimi mund të përshfjethë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrëmbërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe anyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me afërsinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së shoqërisë.



Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Princetobopisopas Audit sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

4 prill 2019

Tiranë, Shqipëri

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor

Raportet Financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	10	76,136	50,574
Aktive të mbajtura për investime	11	189,045	198,995
Aksione në shoqëri të lidhura	12	12,566	9,316
Aktive të risigurimit	13	684,775	723,373
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	14	864,673	706,284
Depozita me afat me bankat	15	733,958	777,638
Shpenzimet e shtyra të marjes në sigurim	17	186,901	197,895
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve dhe të tjera	18	85,759	112,978
Aktive të tjera	16	76,468	67,886
fajle monetare dhe ekuivalentet me to	19	54,827	85,935
TOTALI AKTIVEVE		2,964,908	2,930,974
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	417,471	417,471
Rezerva e rrezikut të sigurimit	20	41,747	41,747
Falset të mbartura		142,169	66,948
TOTALI I KAPITALIT		601,387	526,166
DETYRIMET			
Borxh i varur	21	-	66,562
Detyrime për kontratat e sigurimit	22	886,915	805,235
Rezerva për primet e paguara	23	770,051	805,829
Depozita e risigurve	24	569,033	551,970
Detyrime tatimore dhe të ngjashme	25	24,354	31,216
Tatim fitimi i pagueshëm		3,267	8,944
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	26	103,881	135,052
TOTALI I DETYRIMEVE		2,363,521	2,404,808
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,964,908	2,930,974

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 1 prill 2019 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Gentian Sulaj
Drejtor i përgjithshëm



Ilir Elmazi
Drejtor Financiar

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Prime të shkruara bruto	27	1,678,897	1,666,590
Prime të ceduara të risigurve	28	(781,176)	(846,034)
Ndryshimi në rezervën për primet e paguara bruto	23	29,779	(71,056)
Ndryshimi në rezervën e risigurve për primet e paguara	23	(47,955)	88,030
Prime të fituara neto		879,545	837,530
Të ardhura të tjera	29	12,611	6,744
Të ardhura neto		892,156	844,274
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	22	(81,680)	83,110
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurve	22	9,356	(97,331)
Dëme të paguara bruto	22	(601,445)	(760,651)
Dëme të paguara nga risigurve	22	205,132	347,382
Dëme të sigurimit, neto		(466,637)	(427,490)
Shpenzimet e marjes në sigurim	30	(471,355)	(461,355)
Shpenzime administrative	31	(280,160)	(259,809)
Të ardhura nga komisionet e risigurve	32	459,265	405,006
Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimeve	18	(6,000)	(8,816)
Shpenzime të tjera të sigurimit	33	(33,513)	(25,640)
Fitimi operativ		82,745	66,170
Të ardhura nga Interesi	34	54,126	46,213
Shpenzime financiare		(15,221)	(17,375)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	35	(28,342)	(11,045)
Të ardhura financiare, neto		10,563	17,793
Fitimi para tatimit		93,308	83,663
Tatim mbi fitimin	36	(18,087)	(17,015)
Fitimi i vitit		75,221	66,648
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		75,221	66,648

Raportet Financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e fluksit të parësë

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	2018	2017
Fitimi para tatim fitimit	93,308	83,863
Fluksi i parësë nga aktivitetet e shfrytëzimit		
<i>Prerullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,31	23,191
Ndërmja jashë përdorimit e aktiveve të trupëzuara dhe të paltrupëzuara	-	349
Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtushme nga aktiviteti i sigurimit	18	8,816
Investimi në shoqëritë e lidhura	-	(1,342)
Të ardhura nga interesat e përllogaritura	-	(1,994)
Fluksi i parësë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit	124,600	112,983
Ndryshime në aktive të sigurimit	38,598	9,300
Ndryshime në shpenzimet e shëtyra të marjes në sigurim	10,994	(25,468)
Ndryshime në llogaritë pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	22,502	(45,185)
Ndryshime në aktive të tjera	(8,482)	10,977
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit	81,680	(83,109)
Ndryshime në rezervën për primet e paguara	(29,778)	71,056
Ndryshime në depozitat e siguruesit	17,063	76,373
Ndryshime në detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	(31,171)	71,838
Ndryshime në detyrime tatimore dhe të ngjashme	(5,862)	4,926
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit	219,145	203,691
Tatim mbi fitimin i paguar	(23,744)	(8,640)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	195,401	195,051
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje aktyesh të trupëzuara dhe të paltrupëzuara	10	(20,020)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuar	(42,188)	(161,630)
Randë në depozitat me afat	43,680	(121,834)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese	(160,147)	(117,736)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Shlyerje e borxhit të varur	21	(68,562)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese	(68,562)	(68,562)
(Ujje)rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to	(31,308)	8,470
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	85,935	77,465
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	54,627	85,935

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali themellor	Rezerva	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	1,228,000	53,265	(822,947)	459,218
Fitimi i vitit	-	-	66,948	66,948
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	66,948	66,948
Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve të mbartura	(810,529)	(11,518)	822,047	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	417,471	41,747	66,948	526,166
Fitimi i vitit	-	-	75,221	75,221
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	75,221	75,221
Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve të mbartura	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	417,471	41,747	142,169	601,387

Intersig Vienna Insurance Group sh.a**Pasqyra e ndryshimeve në kapital***(të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Kapitali themeltar	Rezerva	(Humbje)/fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	1,228,000	53,265	(864,803)	416,462
Fitimi i vitit	-	-	42,756	42,756
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin	-	-	42,756	42,756
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,228,000	53,265	(822,047)	459,218
Fitimi i vitit	-	-	66,948	66,948
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin	-	-	66,948	66,948
Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve të mbartura	(810,529)	(11,518)	822,047	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	417,471	41,747	66,948	526,166

Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 46 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Intersig Vienna Insurance Group sh.a
Pasqyra e fluksit të parasë
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2018	2017
Fitimi para tatim fitimit		93,308	83,963
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvierësimi dhe amortizimi	10,31	26,575	23,191
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara		-	349
Zhvierësimi për llogaritë e arkëtushme nga aktiviteti i sigurimit	18	4,717	8,816
Investimi në shoqëritë e lidhura		-	(1,342)
Të ardhura nga intereset e përlogaritura		-	(1,994)
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit		124,600	112,983
Ndryshime në aktive të risigurimit		38,598	9,300
Ndryshime në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		10,994	(25,468)
Ndryshime në llogaritë pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		22,502	(45,185)
Ndryshime në aktive të tjera		(8,482)	10,977
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit		81,680	(83,109)
Ndryshime në rezervën për primet e pafituara		(29,778)	71,056
Ndryshime në depozitën e risiguruesit		17,063	76,373
Ndryshime në detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(31,171)	71,838
Ndryshime në detyrime tatimore dhe të ngjashme		(6,862)	4,926
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit		219,145	203,691
Tatim mbi fitimin i paguar		(23,744)	(8,640)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		195,401	195,051
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	10	(42,188)	(20,020)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuar		(161,639)	(121,834)
Rënie në depozitat me afat		43,680	24,116
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(160,147)	(117,736)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Shlyerje e borxhit të varur	21	(66,562)	(68,845)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese			
(Ulje)/ritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to		(31,308)	8,470
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit		85,935	77,465
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	19	54,627	85,935

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Intersig Vienna Insurance group Sh.a.**Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***Aftësia Paguese**

Aftësia paguese sipas metodës së kapitalit neto më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

<i>Niveli aktual i aftësisë paguese:</i>	2018	2017
Kapitali aksionar	417,471	417,471
Rezerva e sigurisë	41,747	41,747
Fitimet e mbajtura	142,169	65,917
Borxh i varur varur	-	66,562
Aktive afatgjata jo-materiale	(22,131)	(9,126)
Aksione në shoqëri të lidhura	(12,566)	(9,315)
Llogari të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	(29,471)	(28,981)
Aktive të tjera	(84,031)	(70,492)
Niveli aktual i aftësisë paguese	453,188	473,783
Niveli i kerkuar i aftësisë paguese	370,000	370,000
Kapital Surplus/(Deficit)	83,188	103,783
Mjaftueshmëria e kapitalit	I përmbushur	I përmbushur

Intersig Vienna Insurance group Sh.a.
Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit

Në përputhje me vendimin e Qeverisë numër 96 datuar më 3 gusht 2008; shoqëritë e sigurimit që operojnë në Shqipëri nuk mund të investojnë më shumë se raportet e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve që mbulojnë rezervat teknike dhe matematike:

31 dhjetor 2018

Provizionet bruto teknike dhe matematike

	Limiti i investimit si përqindje e provizionit bruto	Limiti i investimit sipas ligjit	Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit
Zëri i vetëm tokë dhe ndërtesa *	10% për pjese	332,593	177,871
Depozita me afat (duke përfshirë fondin e garancisë)	Pa limit	pa limit	341,667
Tituj të tregtuar në tregje të parregulluara	10%	166,297	-
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	Pa limit	pa limit	850,845
Aktive të risigurimit (klasifikimi mbi BBB)	Pa limit	pa limit	684,775
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	20%	332,593	57,546
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3%	49,889	45,805
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	83,148	54,004
Aktive të tjera	2%	33,259	52,113
Interes i llogaritur	5%	83,148	36,119
Totali			2,300,745
Provizionet teknike			1,662,965
Niveli i mbulimit të rezervave teknike			138%

* Shoqëria mund të investojë vetëm në një zë të aktiveve të trupëzuara jo më shumë se 10% të totalit të provizionit teknik. Deri më 31 dhjetor 2018 shoqëria ka në pronësi dy ndërtesa.

Intersig Vienna Insurance group Sh.a.
Skedule suplementare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Provizionet bruto teknike dhe matematike më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

			31 dhjetor 2017
Provizionet bruto teknike dhe matematike	Limiti i investimit si përqindje e provizionit bruto	Limiti i investimit sipas ligjit	Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit
Zëri i vetëm tokë dhe ndërtesa *	10%	322,213	173,291
Depozita me afat (përveç fondit të garancisë)	no limit	pa limit	392,958
Tituj të tregtuar në tregje të parregulluara	10%	161,106	-
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	no limit	pa limit	696,395
Aktive të risigurimit (klasifikimi mbi BBB)	no limit	pa limit	723,373
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme (më pak se 3 muaj)	20%	322,213	140,133
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3%	48,832	48,332
Investime në aktive fikse të ndryshme nga toka dhe ndërtesat	5%	80,553	41,445
Aktive të tjera	2%	32,221	-
Interes i llogaritur	5%	80,553	24,569
Totali			2,240,496
Provizionet teknike			1,611,064
Shkalla e mbulimit në përqindje			139%

* Shoqëria mund të investojë vetëm në një zë të aktiveve të trupëzuara jo më shumë se 10% të totalit të provizionit teknik. Deri më 31 dhjetor 2017 shoqëria ka në pronësi dy ndërtesa.

Treguesi i Likuiditetit
Liquidity Ratio

2018

AKTIVET	ASSET	(mije lek/Thousand ALL)
Mjete Monetare dhe Ekuivalente	Cash and Cash equivalent	54,627.0
Depozita me Afat nga Bankat	Time Deposits	24,017.0
Llogari te Arketueshme nga Sigurimet	Insurance Receivables	56,504.0
Aktive te tjera		24,017.0
Totali i Aktiveve Financiare	Total Financial Assets	159,165.0
DETYRIMET	LIABILITIES	
Detyrime nga Kontratat e Sigurimit	Insurance Contract Liabilities	44,344.0
Depozita Risigurimi	Reinsurance Deposits	7,257.0
Detyrime te Tjera	Other related liabilities	103,881.0
Totali i Detyrimeve	Total Liabilities	155,482.0
	Norma Likuiditetit (Liquidity Ratio)	102%

* Norma e Likuiditetit per vitin 2018 eshte me e madhe se >1.

Raport i permblledhur i rezultateve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2018 në shoqërinë Intersig VIG është kryer në përputhje me Planin Vjetor të Auditit të Brendshëm, të miratuar në Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë. Kryerja e angazhimeve audituese është bazuar në Kartën e Auditit të Brendshëm, në Manualin e Auditit të Brendshëm, në *Parimet kryesore e Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group* dhe në Rregulloren Nr. 153 të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit".

Gjatë vitit 2018 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka audituar aktivitetet e shitjes dhe marrjes ne sigurim, të administrimit, të menaxhimit të riskut, të trajtimit të detyrës, të risigurimeve, të financës dhe të teknologjisë së informacionit, duke mbuluar kështu plotësisht të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë.

Departamenti i Shitjes, Aktivitetet e shitjes ne shoqëri menaxhohen dhe realizohen nga Departamenti i Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme dhe nga Degët e Shitjeve të cilat përmbajnë në strukturën e tyre agjentët e shitjes dhe ndërmjetesit e tjerë të shoqërisë Intersig VIG.

Kontrollet e Auditit të Brendshëm për vitin 2018 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin rregullores së brendshme të shoqërisë, rregjistrimin e saktë dhe pa vonesa të policave ne programin e shitjes, arketimin e primeve vecanerisht për produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive të parashënimeve për shitjen, menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes, procedurat e marrjes së agjenteve të rinj dhe largimin e agjenteve egzistues, etj.

Kontrollet e shitjes së produkteve të detyrueshme, TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare janë përqëndruar më së shumti tek risqet e mundshme që shfaqen si pasojë e gabimeve në rregjistrimet e policave të shitura në programin e shitjes, në saktësinë e të dhënave lidhur me kategorinë e automjetit, periudhën e sigurimit etj.

Departamenti i Marrjes ne sigurim dhe Menaxhimit të riskut. Aktiviteti i marrjes ne sigurim dhe ai i menaxhimit të riskut gjatë vitit 2018 kanë funksionuar të harmonizuara me njëra tjetrën. Për çdo rast Komiteti i Menaxhimit të Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat për percaktimin e primit ne përputhje me rregulloren e brendshme dhe urdhrat e Bordit të Drejtorëve të nxjerra për këtë qëllim. Shoqëria i ka kushtuar vëmendje dhe ka përmirësuar dokumentacionin e nevojshme për analizimin e risqeve të dokumentave të marrjes ne sigurim të pronave.

Departamenti i Administrimit, Angazhimi i auditimit ne këtë departament gjatë vitit 2018 është fokusuar ne: raketimin mujor të agjenteve të shitjes me deget dhe me drejtorinë e përgjithshme; ne analizimin, ndjekjen dhe arketimin e primeve e paarketuara; ne kontrollin e inventarimit fizik të policave gjendje të furnizuara tek agjentët e shitjes; ne zbatimin e procedurave për lëshimin e policave dublikate dhe anulimin e policave; ne funksionimin e programit Edusoft për administrimin e policave (rregjistrimi dhe raportimi ne nivel police, i primeve, arketimeve, debitorëve, komisioneve dhe inventarit); si dhe ne llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve ne përputhje me urdhrat e brendshme të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë.

Departamenti i Ri-sigurimeve, Nga kontrollat e kryera në këtë departament, ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar në Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", në Rregulloren nr.85/1 datë 30.09.2015 e ndryshuar, në Rregulloren e Grupit VIG për Risigurimet dhe në marrëveshjet e lidhura ndërmjet shoqërisë dhe risigurveve përkatës. Partneri kryesor për aktivitetin e risigurimeve është VIG-RE i cili është pjesë e Vienna Insurance Group. Partneret e tjera janë përzgjedhur dhe miratuar bazuar në rankimet ndërkombëtare të institucioneve ndërkombëtare për shoqëritë e risigurimeve. Lista e risigurveve është përditësuar periodikisht në përputhje me rregulloren e brendshme të Grupit VIG.

Kontrollat e auditit të brendshëm kanë konsistuar në përpunime ligjore dhe të zbatimit të rregulloreve në fuqi, njoftimin në kohë dhe miratimin nga ana e Departamentit të Risigurimeve të Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe përcaktimin e ofertave. Gjithashtu janë audituar raportimet periodike në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe në Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Departamenti i Trajtimit të Demeve, Funksionet e trajtimit të demeve, të administrimit financiar dhe të teknologjisë së informacionit janë transferuar në një kompani shërbimi, **VIG Services Shqiperi**. Kriteret e ofrimit të shërbimeve të transferuara dhe treguesit e performancës janë të përcaktuara në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA Agreement) ndërmjet shoqërisë Intersig VIG dhe VIG Services Shqiperi. Kjo marrëveshje është përditësuar në muajin Tetor 2017.

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2018 në aktivitetin e trajtimit të menaxhimit të demeve janë fokusuar në zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi, Rregulloret e AMF për trajtimin e vlerësimit të demeve si dhe zbatimin e Rregulloreve të brendshme të miratuara nga shoqëria. Kontrollat e Auditit të Brendshëm gjatë vitit 2018 kanë synuar të mbulojnë të gjitha llojet e demeve, si ato materiale, motorrike (Kasko dhe TPL); demet e pronës, ashtu edhe demet jomateriale, shëndetsore nga TPL, dhe demet e sigurimit privat të shëndetit. Kontrollat e kryera në Departamentin e Demeve, VIG Services, janë fokusuar në korrektesinë e ekspertimit dhe saktësinë e vlerësimit të demeve; në funksionimin e kontrollit të proceseve të trajtimit të demeve brenda departamentit; në kohezgjatjen e trajtimit të demeve dhe në kujdesin për klientin. Gjatë auditimeve janë kontrolluar si databaza elektronike, regjistrimet në programin e demeve dhe dokumentat e skanuar elektronikisht. Është kontrolluar dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve të demeve, lidhur me krahasimin e përputhshmërisë së tyre, me dokumentacionin e kërkuar në rregullore, si dhe me dokumentat elektronike të rrëgjistruara në programin e trajtimit të demeve.

Kontrollat në trajtimin e demeve materiale nga produktet e detyrueshme kanë konsistuar në: afatet e regjistrimit dhe trajtimit në përputhje me rregulloret e AMF: në problematikat lidhur me funksionimin dhe përmirësimin e programit informatik të trajtimit të demeve; në referencat dhe manualët e çmimeve të përdorur për vlerësimit të saktë dhe të drejtë të demeve, si dhe të kryerjes në kohë të pagesës së demshpërblimit.

Departamenti i Financës Vig.S. Kontrollat janë fokusuar për saktësinë e regjistrimeve në programin e kontabilitetit SAP, dhe në plotësimin me dokumentacionin e kërkuar për transaksionet financiare të rrëgjistruara bazuar në rregulloret të brendshme të shoqërisë dhe të VIG Services. Janë kontrolluar gjithashtu zbatimi i afateve të raportimit, për insitucionet jashtë shoqërisë si (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit të Parave etj.) Janë kontrolluar dhe raportimet e brendshme të departamentit të financës,

lidhur me analizat raportet dhe evidencat financiare, per Departamentet e tjera, per Bordin Drejtues dhe Keshillin Mbikqyres te shoqerise Intersig VIG.

Departamenti i Teknologjise se Informacionit Vig.S, gjate vitit 2018 eshte audituar lidhur me shfrytezimin e sistemeve dhe programeve informatike ne perputhje me rregulloren e brendshme te VIG Service dhe te rregulloreve e udhezimeve te shoqerise Intersig VIG. Jane kontrolluar aktivitetet lidhur me implementimin e programit te ri te shitjes, administrimit dhe demeve (Programi MBA), Gjate vitit 2018 jane kryere kontrole, edhe per masat e sigurimit dhe te kufizimeve perkatese, lidhur me proceset per aplikimin e sakte te hierarkise se te drejtave te perdoruesve, per rinovimin e pajisjeve hardware dhe perditimin e licencave ne perdorim, sidheper dhenien e suportit te IT, per te gjithë perdoruesit e sherbimeve (punonjesit) si dhe mirembajten e sistemeve te sigurise te instaluar ne ambientet e shoqerise.

Departamenti Ligjor, Kontrollet e ushuara ne aktivitetin e ketij departamenti eshte e fokusuar ne perfaqesimin dhe mbrojtjen e shoqerise ne proceset gjyqesore me objekt trajtimin e demeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato te fondit te kompensimit. Gjithashtu pjese e kontroleve te aktiviteve juridike te shoqerise kane qene ndjekja dhe mbeshtetja ligjore, per grumbullimin e primeve te paarketuara nga klientet dhe subjektet debitore. Kontrollet e kryera gjate kesaj periudhe, jane fokusuar edhe ne analizen, percaktimin dhe vleresimin e risqeve qe mund te vijne nga demet me proces gjyqesor, si dhe dhenien e rekomandimeve perkatese per zgjidhjen me eficence te tyre.

Opinion i permbledhur i Auditit te Brendshem

Auditimet dhe kontrollet e realizuar gjate vitit 2018 kane mbuluar te gjitha aktivitetet e shoqerise bazuar ne analizen e riskut dhe ne perputhje me planin vjetor te miratuar te auditimit. Angazhimet audituese jane finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet perkatese, te cilat jane pasqyruar ne raportet e auditimit te derguara ne Subjektin e audituar, ne Bordin Drejtues te shoqerise, si dhe ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise Interig Vig.

Auditi i Brendshem ka qene ne komunikim te vazhdueshem me Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, duke marre mbeshtetje te plote per realizimin e rekomandimeve. Në mënyrë të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara dhe statusin përfundimtar te realizimit të tyre.

Opinion i pergjithshem i auditit eshte se gjate vitit 2018 nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale te konsiderueshme, të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm

Shkelqim Zhurda

Uran Caushi

1. Vetëvlerësimi dhe monitorimi i Rreziqeve të Shoqërisë

Procesi i vetëvlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve të shoqërisë përbehet nga disa faza:

- i. Procesi i Kontrollit të Rreziqeve
 - a. Identifikimi i rreziqeve
 - b. Kuantifikimi
 - c. Planifikimi
 - d. Ndërmarrja e rreziqeve
 - e. Mitigimi
 - f. Monitorimi
 - g. Reagimi
- ii. Prova e Rezistencës
- iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese
- iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit
- v. Profili i Përgjithshëm i Rrezikut

2. Procesi i Kontrollit të Rreziqeve

- a. Sipas analizave të kryera nga shoqëria dhe të raportuara të shoqëria mëmë, Vienna Insurance Group, tre risqet kryesore me të cilat përballet janë të listuara si më poshtë. Këto janë risqet (përfshirë dhe kategoritë e nen-risqeve) tek të cilat do të fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.
 1. Risku i marrjes në sigurim
 2. Risku operacional
 3. Risku i tregut
- b. Kuantifikimi i risqeve kryesore është etapa e dytë në këtë fazë. Llogaritjet kapitalin që i duhet dedikuar një risku të caktuar.
- c. Në fazën e planifikimit përcaktohen kufinj të minimale dhe maksimale të rreziqeve. Njësitë vendosin limitet e risqeve të cilëve do t'u përmbahen. Në anën tjetër, Bordi ka përgjegjësinë të përcaktojë luhatjen e lejuar.
- d. Në këtë fazë përcaktohen se cilat risqe mund të ndërmërrin brenda kufinjve të përcaktuar, dhe cilat risqe duhet të shmangen/transferohen totalisht.
- e. Vendosen metodat e mitigimit të rreziqeve që duhet të transferohen për të ulur efektin e këtyre risqeve dhe për t'i mbajtur brenda limiteve të paracaktuar.
- f. Monitorimi i rregullt është praktikë normale, për të pasur nën vëzhgim sidomos nëse risqet me efekt të madh materializohen, bëhet një monitorim i shpeshtë (p.sh. 1 ose 3-mujor).
- g. Në rast se nivelet e risqeve janë larg limiteve të vendosura, merren masa për mitigimin e tyre.

3. Prova e Rezistencës

Prova e rezistencës është një teknike e cila përdoret për të matur ndjeshmërinë e shoqërisë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kanë një efekt të madh në këtë lloj testimi. Risqet si ato të tregut, të kreditit apo operacionale janë drejtpërdrejtë të lidhur me luhatjet në normat e interesave, çmimet e aseteve, dhe kursin e këmbimit. Megjithatë, risku primar i shoqërisë, risku i sigurimit, nuk është i varur direkt nga këto ndryshime në ekonomi.

Prova e rezistencës do të fokusohet në këto pika, të cilat janë të karakterit të marrjes në sigurim dhe të investimit, dhe që do na ndihmojnë të kuptojmë mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë në këto rrethana të veçanta:

- h. Mbizotërimi i produkteve të caktuara në portofol
- i. Profitabiliteti sipas produkteve për të kuptuar burimin e përqindjes më të madhe të fitimit
- j. Përdorimi i mënyrave të transferimit të riskut (psh. risigurimi)
- k. Kohëzgjatja e detyrimeve
- l. Përbërja e aseteve (pasuri të paluajtshme, hua, obligacione etj.)
- m. Ndërlidhja me kompani të grupit (psh. risigurime brenda grupit)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

Rreziqet që analizohen gjatë vetëvlerësimit dhe të cilat administrohen nga shoqëria kategorizohen si më poshtë:

Analiza e rreziqeve të lidhura me aktivitetin:

- a. Risku i marrjes në sigurim
- b. Risku i katastrofave

Analiza e rreziqeve jo të lidhura me aktivitetin:

- a. Risku i normës së interesit
- b. Risku i pasurive të paluajtshme
- c. Risku i kursit të këmbimit
- d. Risku i kreditit
- e. Risku i përqendrimit
- f. Risku i likuiditetit

Administrimi i rrezikut të sigurimit

- Shoqëria merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këto kontrata.
- Rreziku i sigurimeve lidhet me pasigurinë e biznesit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të normave të primit të sigurimeve dhe përshtatshmërinë e provigjoneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe bazën e kapitalit.
- Shoqëria menaxhon rrezikun përmes strategjisë së risigurimit dhe të marrjes në sigurim brenda kontureve të një menaxhimi risku të përgjithshëm. Vendorsja e çmimeve bëhet bazuar në trendet dhe përvojat e kaluara. Ekspozimi menaxhohet duke pasur të dokumentuar limitet dhe kriteret e marrjes në sigurim. Risigurimet realizohen për t'i lehtësuar Shoqërisë efektin e humbjeve të mundshme nga ngjarjet individuale të mëdha apo katastrofave, si dhe për të siguruar akses të specialistëve të rrezikut dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risigurues të aprovuar, mbi bazën e një marrëveshjeje proporcionale ose mbi bazën e një marrëveshjeje të tejkalimit të humbjes.

INFORMACION PER TAKSAT DHE TATIMET E ZBATUESHME NE FUSHEN E SIGURIME:

Për kontratat e sigurimit, Primet e sigurimit janë të zbatueshme taksat dhe tatimet si më poshtë:

LIGJ Nr. 92/2014 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹
Neni 53 “Përgjashtime për disa veprimtari të tjera”

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

- a) shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit.

LIGJ Nr.9975, datë 28.7.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE I NDRYSHUAR

Neni 4 Niveli i taksave Kombetare

10. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është **10 për qind e shumës së primit.** (Ndryshuar me Ligj Nr.127/2016, date 15.12.2016. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 250 datë 27.12.2016).

Për pagesat e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve nuk aplikohen taska/tatime për shkak se nuk konsiderohen të ardhura.